



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë-Ured Ministra Pravde-Office of the Minister of Justice

Nr. 35 /2025

Datë: 30/01/2025

Në mbështetje të nenit 9, nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare nr. 7/01 mars 2019), në pajtim me nenin 371 (paragrafi 2) të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare nr. 3/2013, 31.01.2013), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore (Gazeta Zyrtare nr. 15/2017, 11.05.2017), si dhe në përputhje me nenin 11 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.5) të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, në pajtim me shtojcën 1, (pika 3) të Rregullore (Qrk) - Nr. 14/2023 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive, si dhe bazuar në nenin 5 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MD-NR. 09/2014 për Procedurën Disiplinore ndaj Përmbartuesit Privat, Ministria e Drejtësisë nxjerr:

V E N D I M

1. PRANOHET kërkesa e z. Rushit Hoxha, anëtar i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, për përjashtim në rastin disiplinor: DPSDPLS.nr. 01/2025, të iniciuar nga SWISS BAU SHPK, të cilin me autorizim në shkresat e lëndës e përfaqëson z. Lirim Ismajli, avokat nga Prishtina, ndaj Përmbartuesit Privat z. Enis Hoxha, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prizren.
2. AUTORIZOHET zëvendës anëtari i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbartuesit Privat, z. Besnik Aliu, i emëruar sipas vendimit të Ministres nr. 173/2023 dt. 28.08.2023, për vendosje në rastin disiplinor DPSDPLS.nr. 01/2025, të iniciuar nga SWISS BAU SHPK, të cilin me autorizim në shkresat e lëndës e përfaqëson z. Lirim Ismajli, avokat nga Prishtina, ndaj Përmbartuesit Privat z. Enis Hoxha, i emëruar për territorin e Gjykatës Themelore në Prizren.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.
4. Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.

Arsyetim

Z. Rushit Hoxha, anëtar i Komisionit Disiplinor ndaj Përmbauesit Privat, me dt. 29.01.2025 ka kërkuar përjashtim nga vendosja në rastin disiplinor të cekur në dispozitiv të këtij vendimi, me qëllim të parandalimit të konfliktit të mundshëm të interesit sepse nga shkresat e lëndës është gjetur se palët e përfshira në këtë rast disiplinor, janë të regjistruara si palë në zyrën e tij përmbaimore me nr. të rastit P.nr. 1124/21. Dokument përmbaimore të trajtuara nga zyra e tij përmbaimore ka qenë marrëveshja noteriale e lidhur mes këtyre palëve, që edhe tek rasti disiplinor që është në trajtim në komisionin disiplinor, dokumentet e besueshme kanë rrjedhur nga e njëjta marrëdhënie mes këtyre palëve, për periudhën e njëjtë kohore, përpos që tek zyra përmbaimore pala ankuese ka qenë kreditor ndërsa tek rasti disiplinor për të cilin është kërkuar përjashtimi pala ankuese është paraqitur si debitor.

Ministrja e Drejtësisë pasi shqyrtoj kërkesën bëri shikimin në shkresat e lëndës dhe duke i analizuar në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbaimore dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore gjeti se kërkesa është e bazuar dhe vlerëson se përjashtimi i anëtarit të Komisionit Disiplinor në lidhje me këtë rast do të ndikoj pozitivisht në rritjen e besimit të palët për objektivitetin e Komisionit Disiplinor.

Andaj, bazuar në atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.



Vendimi i dërgohet:

- Kryesuesit dhe Anëtarëve të Komisionit,
- Sekretares së Përgjithshme;
- Kabinetit të Ministres
- Përmbauesit Privat,
- Departamentit për Politika të Sistemit të Drejtësisë, Profesione të Lira dhe Statistika,
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.